



Ambasadori Aziz K. Pollozhani ka shërbyer si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Kombet e Bashkuara (OKB) në Gjenevë në periudhën 2009-2012.

Nga viti 1998 filloi karrierën e tij politike deri në vitin 2008 si deputet i zgjedhur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (1998, 2002 dhe 2006). Gjatë kësaj periudhe (2002-2006) ka shërbyer si Ministër i Arsimit dhe Shkencës në Qeverinë e R. të Maqedonisë. Së fundi, nga viti 2009-2012, profesor Pollozhani ka shërbyer si ambasador i RM-së në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë.

Gjatë mandatit të tij të parë si deputet ka qenë anëtar i grupit negociator për Marrëveshjen Kornizë të Ohrit të nënshkruar më 13 gusht 2001 në Ohër.

Nga viti 1999-2002 dhe 2006-2008 ka qenë anëtar i Delegacionit Parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg.

Gjatë katër viteve të tij si Ministër i Arsimit dhe Shkencës (2002-2006), ai ishte në krye të reformave thelbësore në arsim dhe ishte bashkëautor i reformave të tjera në lidhje me detyrimet që dalin nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit në fushën e qeverisjes vendore, ndarjen e re teritoriale të RMV, në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore dhe mbrojtja e fëmijëve.

Duke qenë i diplomuar në mjekësi, ai filloi karrierën e tij profesionale si kirurg në Klinikën Universitare të Prishtinës. Prof. Dr. Pollozhani ka kryer studimet pasuniversitare dhe specializimin për kirurgji të përgjithshme dhe vaskulare në Zagreb, Kroaci dhe për kirurgjin plastike rekonstruktive Spitalin Universitar në Cyrih, Zvicër. Ka përfunduar doktoraturën në Universitetin e Tiranës, me temën "Komunikimi kompetent në organizimin e sitemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Maqedonisë".

Pas kthimit nga posti i tij diplomatik, ai u bë udhëheqës i Departamentit për të drejtat e pacientit dhe bioetikën në Institutin e Shëndetit Publik në Republikën e Maqedonisë, ku shërbeu si drejtor i përgjithshëm 2008-2009. Ai gjithashtu vazhdoi punën si Profesor i Shëndetit Publik.

Profesor Pollozhani ka botuar punime shemncore në fushën e Kirurgjisë, Shëndetit Publik dhe Biomjekësisë si dhe në fushën e Edukimit si dhe disa libra universitare dhe publicitike. Ai shërbeu si kryeredaktor i Revistës Ndërkombëtare Mjekësore Shkencore "Medicus" (2012-2016) dhe themelues dhe kryeredaktor i SEEJSD (Journal of Sustainable Development Europe) 2016- dhe tani

Prof. Dr. Azis Pollozhani është Rektor i parë themelues i Universitetit Publik të sapothemeluar "Nënë Tereza" në Shkup (2016-2022) Ai po vazhdon me përkushtim punën e tij si profesor ordinar në Universitetin Nënë Tereza në Shkup dhe është anëtar i Këshillit të amabsadorëve të Maqedonisë së Veriut. Është i lindur në Strugë dhe tani jeton në Shkup.